



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 204 Prot.

Tiranë, më dt. 18.04.2018

**VENDIM**

**Nr.181, dt. 18.04.2018**

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.04.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit "Altari në Parkun Arkeologjik Orik", hartuar nga DRKK Vlorë.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas pikës 5, neni 17, të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

**KRYETAR**

**Mirela Kumbaro Burzhi**

